



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI I TIRANËS

Kuotat e pranimit në Universitetin e Tiranës për vitin akademik 2018-2019, për kandidatë nga trojet shqiptare, shtetas të huaj, kategoritë e veçanta (me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe kandidatët studentë Romë dhe Ballkanë-egjiptianë) transferim studimesh apo një program të dytë studimi në programet e ciklit të parë të studimeve, me kohe të plotë, janë miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 21.06.2018 të Senatit Akademik të UT.

Kuotat janë miratuar në nivel universiteti, të cilat janë në dispozicion për çdo program studimi të UT. Kuotat e miratuara janë si vijon:

- a) Kuotat e pranimit për kandidatët studentë nga trojet shqiptare: **179 kuota.**
- b) Kuotat e pranimit për kandidatët studentë shtetas të huaj: **41 kuota.**
- c) Kuotat e pranimit për kandidatët studentë nga kategoritë e veçanta (me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe kandidatët studentë Romë dhe Ballkanë-egjiptianë): **179 kuota.**
- d) Kuotat e pranimeve për kandidatët studentë që aplikojnë për transferim studimesh: **170 kuota.**
- e) Kuotat e pranimit për kandidatët studentë që aplikojnë për një program të dytë studimi: **97 kuota.**

Vendim Senatiti Akademik: Nr. 17, Tiranë më 21.06.2018, “Mbi miratimin e kuotave të pranimit në programet e studimeve të ciklit të parë Bachelor dhe në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në fushën e drejtësisë, për vitin akademik 2018-2019”

Aplikimi i kandidatëve bëhet pranë sekretarive të njësive kryesore të UT. Afatet kohore të aplikimit, regjistrimit si dhe dokumentacioni i duhur paraqiten në Udhëzim: Nr. 26, datë 30.07.2018 të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Udhëzim: Nr. 26, datë 30.07.2018, “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2018 - 2019”

Shënim: Informacioni gjëndet në format PDF, për ti aksesuar do t'ju duhet të keni softtëare Adobe Reader. Nëse ju kërkohet versioni do ta gjeni në linkun <https://get.adobe.com/reader/>